



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË
BORDI

VENDIM

Nr. 209, Datë 27.06.2023

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 16.11.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENER GjISË ELEKTRIKE NGA HEC “KAMIÇAN”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1860 KW”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 52 pika 3 dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1722/3 prot., datë 26.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 16.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan” me kapacitet të instaluar 1860 kW”, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar me vendimin e bordit nr. 259, datë 21.12.2021, ka vendosur:
 1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kamiçan”, me kapacitet të instaluar 1860 kW, për një afat 30 vjeçar.
 2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të rinovimit si dhe të depozitojë në ERE, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre:
 - a. Kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, me nr. 1322 prot., datë 28.02.2018, të lidhur me Bashkinë Elbasan;
 - b. Kontratën e qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, me nr. 7126 prot., datë 10.12.2017, të lidhur me Bashkinë Gramsh;
 - c. Lejen për përdorim të burimit ujor, me nr. 1196 Prot., datë 30.10.2018.
 3. Mos plotësimi i kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.

4. *Shfuqizuar.*

5. *Shoqëria të depozitohet në ERE miratimin e lejes së ndërtimit, me qëllim plotësimin e kushtit të parashikuar në pikën 3.78 të VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 07 Vendimi, datë 11.02.2020, jo më vonë se data 11.02.2022.*

- Kushtet e vendosura në pikën 2, gërmat “a” dhe “b” dhe në pikën 5 të këtij vendimi, janë të lidhura me njëra-tjetrën, pasi leja e ndërtimit, nuk përbën një dokument që kërkohet në kuadër të licencimit të një subjekti, por në rastin konkret është kërkuar për plotësimin e kushtit të parashikuar në pikën 3.78 të VNM-së Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 07 Vendimi, datë 11.02.2020 dhe që lidhet me afatin e vlefshmërisë së kësaj VNM-je, dhe po ashtu në kuptim të përcaktimeve të fillimit të efekteve juridike dhe financiare të kontratave të qirasë, me qëllim përlogaritjen e afatit të tyre.
- Në kuadër të qartësimit përfundimtar të dokumentacionit të kërkuar për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 188/2020, i ndryshuar, dhe po ashtu me qëllim sqarimin e efekteve juridike të kontratave të qirave, është zhvilluar një seancë dëgjimore në datën 09.09.2022 dhe korrespondencë shkresore me shoqërinë (nr. 113 prot., datë 20.01.2022, deri 113/15 prot., datë 29.09.2022, nr. 1722 prot., datë 01.06.2023, nr. 1722/1 prot. datë 14.06.2023, nr. 1722/2 prot., datë 20.06.2023). Po ashtu, ERE i është drejtuar dhe Bashkisë Elbasan me kërkesë për informacion, por nga ana e sa nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Në vijim të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të këtyre kushteve, shoqëria ka argumentuar se në zbatim të përcaktimeve të nenit 5.2 të kontratave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik, të lidhura përkatësisht me Bashkinë Elbasan dhe Bashkinë Gramsh, ka shlyer të gjitha detyrimet ligjore dhe financiare dhe se këto kontrata kanë filluar fuqinë e tyre juridike nga momenti i lëshimit të faturave për arkëtim nga Bashkitë përkatëse dhe kryerjes së pagesave të tyre respektivisht më datë 19/09/2022 me Bashkinë Elbasan dhe më datë 19/09/2022 me Bashkinë Gramsh. Në këto rrethana dhe afati 10-vjeçar i vlefshmërisë së këtyre kontratave ka filluar më datë 19.09.2022.
- Po ashtu, shoqëria ka dokumentuar në ERE dhe përpjekjet e saj për të regjistruar kontratën me MIE-n në ASHK-në përkatëse, në lidhje me të drejtën e përdorimit të pronës në zonën ku shtrihet projekti, dhe për këtë ka depozituar në ERE kërkesën e datës 09.09.2022, që i ka drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK-së Elbasan dhe Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gramsh në lidhje me këtë regjistrim.
- Në përgjigje, me shkresën nr. 544/ 1 prot., datë 29.09.2022, nga Drejtoria Vendore Elbasan është bërë me dije se pasuritë e përfshira në kontratë, të cilat janë të fondit pyjor dhe kullësor, rezultojnë të ndodhura jashtë zonave të rëlevuara, pra nuk është kryer regjistrim fillestar referuar pozicionit gjeografik ku dhe ato shtrihen.
- Pas marrjes së kësaj përgjigjeje, shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka vënë në dijeni ERE-n se po vlerëson mundësinë që të komunikojë me bashkitë përkatëse për të vijuar këtë proces privatisht, nëpërmjet studiove të licencuara për kryerjen e rëlvimit të zonave ku shtrihet projekti e se në çdo rrethanë do të njoftojë ERE-n për mënyrën e ndjekjes së kësaj çështjeje.

- Në këto rrethana dhe referuar sa sqaruar në lidhje me fillimin e efekteve ligjore të kontratave të qirasë, e referuar përpjekjeve të bëra nga ana e shoqërisë për të regjistruar kontratën me MIE-n në ASHK-në përkatëse, vlerësohet që gërmat “a” dhe “b” të pikës 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 188/2020, i ndryshuar, të ndryshohen, duke i lënë detyrën shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratat e rinovuara të qirasë brenda datës 19.09.2032, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shrihet projekti i HEC “Kamiçan”.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, gërma “c” të këtij vendimi, ku është përcaktuar se shoqëria duhet të depozitojë në ERE të rinovuar *Lejen për përdorim të burimit ujqor, me nr. 1196 Prot., datë 30.10.2018*, rezulton se kjo leje është aktualisht e vlefshme (referuar vendimit të Këshillit të Basenit Ujqor (KBU) Seman, nr.18, datë 25.10.2018, afati i vlefshmërisë së saj është deri më 25.10.2023), por vlerësohet ndryshimi/qartësimi i këtij kushti, duke përcaktuar datën brenda të cilës shoqëria duhet të depozitojë në ERE këtë leje të rinovuar, pra brenda datës 25.10.2023.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 5 të vendimit, në rrethanat kur shoqëria ka depozituar në ERE, VNM-në paraprake të rinovuar, me numër serie AN310120220008, Komisioni 16, datë 30.03.2022, e po ashtu rezulton se vepra është ndërtuar, pasi nga raportimet e operatorëve të rrjetit dhe “Furnizuesit të Tregut të Lirë” sh.a. rezulton se hidrocentrali është në prodhim që nga viti 2021, kjo pikë konsiderohet e plotësuar e si e tillë duhet të shfuqizohet.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
 2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., të depozitojë në ERE:
 - a. Brenda datës 19.09.2032, Kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, të lidhur me Bashkinë Elbasan, si dhe Kontratën e rinovuar “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, të lidhur me Bashkinë Gramsh, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC Kamiçan.
 - b. Brenda datës 25.10.2023, Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC Kamiçan.
2. Pika 5 e vendimit të bordit të ERE-s, nr.188, datë 16.11.2020, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., Minsitrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI